

"Nxitja e prodhimit artizanal, kulturës dhe ekoturizmit"

Konteksti

Me synimin për të nxjerrë në pah prodhimtarinë artizanale, kulturën dhe turizmin ekologjik, HAMLET është një nismë që synon të rrisë atraktivitetin e pasurive natyrore dhe kulturore për të përmirësuar një zhvillim ekonomik tërheqës dhe të qëndrueshëm.

HAMLET trajton valorizimin e qendrave historike, fshatrave dhe qyteteve të vogla dhe përfshin zonat e përzgjedhura në qarqet turistike si dhe synon të rrisë bashkëpunimin dhe rrjetëzimin ndërmjet tre vendeve të Mesdheut, duke punuar drejt identifikimit të veçorive në zonën e Adriatikut.

Financuar nga Programi IPA CBC INTERREG, nisma synon të minimizojë përpjekjet ekonomike të secilit vend dhe në të njëjtën kohë të maksimizojë ndikimin pozitiv në ruajtjen e trashëgimisë. Pritshmëria kryesore mbetet rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit mbi trashëgiminë lokale, përfshirja e komunitetit dhe entiteteve publike në promovimin e turizmit dhe përmirësimi në fushën e përfshirjes sociale dhe punësimit.

Objektivat e projektit

- Zgjerimi i mundësive turistike duke promovuar destinacione dhe produkte të reja;
- Zhvillimi i një turizmi të aksesueshëm nga publiku;
- Mbështetja e sektorit artizan;
- Zgjerimi i mundësive turistike duke promovuar destinacione dhe produkte të reja;
- Zhvillimi i një turizmi të aksesueshëm nga publiku;
- Mbështetja e sektorit artizan.



Zbatimi i projektit

Italia, Shqipëria dhe Mali i Zi njihen për prezencën e pasurive të shumta natyrore, fshatrave historike dhe qyteteve të vogla dhe projekti do të zbatohet në territore të karakterizuara nga monumente, artefakte historike dhe pasuri natyrore që aktualisht nuk shfrytëzohen plotësisht, por që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ofertën e turizmit kombëtar.

Përtej modernizimit të sinjalistikës turistike, me një vëmendje të veçantë për shërbimet dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara, projekti synon të kryejë një hartëzim gjeografik dhe kulturor, duke ofruar një listë të plotë të traditave historike, punimeve dhe veçorive natyrore, në mënyrë që të zhvillojë një ofertë të re turistike me itinerare të reja dhe aktivitete të grupuara nën një markë të përbashkët.

FAKTET KRYESORE

DONATOR:

Komisioni i Bashkimit Evropian

PARTNERË:

- Ministria e Kulturës Shqipëri
- Ministria e Kulturës Mal i Zi
- Puglia Promozione
- Instituti i Kërkimeve Urbane
- CNA Bari
- Unioni i Bashkive Mal i Zi
- Rajoni Pulia

KOHËZGJATJA:

1 Prill 2018 – 4 Prill 2020

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14

Hyrja 11, Ap. 56

Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: info@uri.org.al

web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.